

VENDIM
Nr.812, datë 6.10.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E
MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integrimit,
Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
2010-2014”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
2010-2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha